



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 352/2 Prot.

Durrës, më 21.2.2023

VENDIM

Nr 14, datë 21.2.2023

**"PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË TRAJTIMIT FINANCIAR TË NGARKESËS
MËSIMORE TË REALIZUAR NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE
DOKTORATË"**

Bazuar në pikën 8 të nenit 59 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ku cilësohet "ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në institucionet publike të arsimit të lartë përcaktohet nga institucioni, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Në institucionet jopublike ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni", në pikën 4/b/iii të kapitullit I të udhëzimit nr. 29 datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" dhe gërmën ç të pikës 12 të kapitullit II të Udhëzimit 29, Vendimin nr. 51, datë 11.11.2022 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e pagesës së orëve mësimore të realizuara mbi mësimdhënien e normuar vjetore të realizuara jashtë auditori për vitin akademik 2021 – 2022, nga personeli akademik me kohë të plotë i Universitetit "Aleksandër Moisiu", shkresën prot.nr., 1887, datë 13.12.2022 me objekt "Përcillen për pagesë formularët e ngarkesës mësimore për "Ciklin e tretë të studimeve "Doktoraturë" për vitin akademik 2021-2022" të Fakultetit të Biznesit, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin paraparak për trajtimin financiar të ngarkesës mësimore të realizuar në ciklin e tretë të studimeve Doktoratë deri në 240 orë, sipas Udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".
2. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

